Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada –Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, dt. 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 15 paragrafi 3 Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, dt. 12 qershor 2009,

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 12/2011
PËR PAGESA DIREKTE NË BUJQESI PËR VITIN 2011

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcakton rregullat për zbatimin e pagesave direkte në bujqësi për vitin 2011 në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës PZHRB 2007 – 2013 si dhe i përcakton përfituesit, kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat e përkrahjes.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë domethënie:

1.1 "**Pagesë e direkte**" – nënkupton pagesën e dhënë drejtpërdrejt fermerit në bazë të njësisë së sipërfaqes së tokës bujqësore apo për krerë/kafshë;

1.2 **"Sipërfaqe e tokës bujqësore"** nënkupton sipërfaqen e tokës së punueshme, kullosa ose sipërfaqe me kultura shumëvjeçare;

1.3."**Aplikues**" nënkupton personin i cili aplikon për mbështetje financiare për pagesa direkte;

1.4 "**Përfitues**" nënkupton personin i cili përfiton pagesën direkte nga Ministria;

1.5 "**Parregullsi**" nënkupton veprimin apo lëshim nga ana e përfituesit e cili bie ndesh me legjislacionin në fuqi dhe këtë udhëzim administrativ;

1.6 ”**Mashtrim**” nënkupton veprimin e qëllimshëm ose lëshimin lidhur me përdorimin ose paraqitjen e deklaratave ose dokumenteve të rrejshme, të cilat kanë ndikim negativ në buxhetin e Kosovës;

1.7 “**Ministria**” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

1.8 “**Njësia e Pagesave**” nënkupton njësinë organizative të Ministrisë për të përkrahur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural;

1.9 “**Kafshë e përcaktuar**” nënkupton një kafshë për të cilën janë plotësuar të gjitha kushtet e parashtruara në rregullat për dhënie të përkrahjes në veçanti numri i kafshëve të gjetura gjatë kontrollit në teren;

1.10 **Sipërfaqe e përcaktuar**” nënkupton sipërfaqen e mbjellur me grurë dhe e verifikuar gjatë kontrollit në teren.

1.11 **“sLPIS”** nënkupton Sistemin e Identifikimin të Parcelave të Tokës dhe softuerin përkatës për skicimin e parcelave të shfrytëzuesve të tokës dhe futjen e të dhënave për parcela në serverin qendror.

Neni 3
Lloji dhe kushtet e përgjithshme për përkrahje

1. Me qëllim të shtimit të të ardhurave të bujqve për të siguruar një qëndrueshmëri ekonomike, pagesat direkte bëhen për:

   1.1 Njësi të sipërfaqes të mbjellë me grurë;

   1.2 Pagesë për krerë të lopëve qumështore;

   1.3 Pagesë për krerë të deleve dhe dhive qumështore.

2. Pagesat direkte nga paragrafi 1 i këtij neni bëhen për përfituesit që përmbushin kriteret e caktuara në bazë të këtij udhëzimi administrativ.

3. Pagesat direkte bëhen në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4
Aplikuesit

1. Aplikues për përkrahje të drejtpërdrejtë mund të jenë personat fizik apo juridik.

2. Personat fizik, duhet të jenë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës ndërsa personat juridik, duhet të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë.

Neni 5
Përkrahje financiare

1. Përkrahja sigurohet në kornizën e buxhetit në dispozicion.

2. Pagesat e drejtpërdrejta për njësi të sipërfaqes dhe për krerë të kafshëve do të llogariten, duke e ndarë shumën e përgjithshme të buxhetit për pagesa direkte për krerë kafshësh apo njësi të sipërfaqes së përcaktuar.

Neni 6
Përgatitja dhe zbatimi i programit

1. Përgatitja e programit për përkrahje të drejtpërdrejtë dhe monitorimi i zbatimit të tij është përgjegjësi e Autoritetit Menaxhues të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i cili miratohet nga Ministri.

2. Programi i përkrahjes për pagesa të drejtpërdrejta përbëhet nga një analizë e gjendjes së tanishme, prioriteteve dhe masave për strategjinë, përshkrimi i masave dhe kushteve - kriteret e pranueshme, plani financiar për zbatim, metoda e zbatimit, mekanizmat e zbatimit,

monitorimi, vlerësimi i ndikimit të masave të zbatuara dhe mekanizmat për sigurimin e transparencës.

3. Zbatimi administrativ/teknik i këtij programi për pagesa direkte është përgjegjësi e Njësisë së Pagesave në kuadër të MBPZHR-së.

4. Zbatimi i kontrollit në teren bëhet nga Njësia e Pagesave dhe mbështet nga departamentet përkatëse teknike dhe inspektorët e Ministrisë.

5. Njësia e pagesave do të përdorë të dhënat nga shërbimi kadastral komunal dhe Njësia për Identifikim dhe Regjistrim në Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinës.

6. Njësia e pagesave zbaton programin dhe të gjitha procedurat tjera administrative teknike dhe raporton te Autoriteti Menaxhues si dhe sipas kërkesës së Ministrit.

Pagesat direkte për vitin 2011
Pjesa e I - Pagesat direkte për lopë qumështore

Neni 7
Kriteret e pranueshme

1. Kriteret e pranueshme për pagesa direkte për lopë qumështore në prodhimtarinë aktive janë:

1.1 Minimumi i krerëve të kafshëve të jenë së paku 5 lopë qumështore;

1.2 Maksimumi i krerëve të kafshëve që do të përfitojnë nga kjo masë është 30 krerë lopë qumështore;

1.3 Kafshët, duhet të jenë të matrikuluara me matrikull të Republikës së Kosovës;

1.4 Aplikuesi, duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Pjesa 2 – Pagesat direkte për dele dhe dhi qumështore

Neni 8
Kriteret e pranueshme

1. Kriteret e pranueshme për pagesa direkte për dele dhe dhi qumështore në prodhimtarinë aktive janë:

1.1 Minimumi i krerëve të jenë së paku 30 krerë dele dhe së paku 20 dhi;

1.2 Maksimumi i krerëve që do të përfitojnë nga kjo masë është 500 krerë dele dhe dhi;

1.3 Kafshët, duhet të jenë të matrikuluara me matrikull të Republikës së Kosovës;

1.4 Aplikuesi, duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Pjesa 3 – Pagesat direkte për grurë

Neni 9
Kriteret e pranueshme

1. Kriteret e pranueshme me sipërfaqe e mbjellura me grurë, janë:

1.1 Të kenë mbjellë së paku 2 ha tokë me grurë në pronësi;

1.2 Parcela e mbjellur me grurë, duhet të jetë në minimum 0,20 ari;

1.3 Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një (1) vit;

1.4 Sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë 1 ha e pandarë;

1.5 Aplikuesi, duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Procedurat për zbatimin e pagesave direkte

Neni 10
Procedurat administrative

1. Procedurat për ofrimin e përkrahjes sipas këtij udhëzimi administrativ do të zbatohen përmes dorëzimit të aplikacioneve, shqyrtimit administrativ të aplikacioneve dhe kontrolleve në teren – vendngjarje si dhe ekzekutimi i pagesave.
2. Futja e të dhënave në sistemin e sLPIS për pagesa direkte sipas nenit 9 të këtij udhëzimi administrativ zbatohen për komunat të cilat e kanë të vendosur sistemin e sLPIS-it.
3. Zbatimi i procedurave administrative bëhet sipas Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative.

Neni 11
Njoftimi publik

1. Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen e njoftimit dhe thirrjes për aplikim.
2. Njoftimi dhe thirrja për aplikim nga paragrafi 1 i këtij neni i dorëzohet Zyrës për komunikim me publikun në MBPZHR e cila është përgjegjëse për shpalljen publike për masat mbështetëse për vitin 2011.

Neni 12
Dorëzimi i aplikacioneve

1. Aplikacioni për mbështetje dorëzohet në dy kopje brenda afatit sipas shpalljes publike, me dokumentacionin e kërkuar në Njësinë komunale përkatëse për bujqësi.
2. Formulari i aplikacionit për të gjitha pagesat direkte i sigurohet përfituesit falas nga Njësitë komunale përkatëse për bujqësi ose mund të shkarkohet nga web faqja e Ministrisë.
3. Aplikacioni dorëzohet personalisht nga aplikuesi ose i autorizuari i tij.
4. Aplikuesi me nënshkrimin e tij siguron që të gjitha informatat e dhëna të jenë të qarta, të besueshme dhe se ai do të lejon kryerjen e kontrollit në teren.

Neni 13
Dokumentacioni i nevojshëm

1. Aplikuesi, duhet të sigurojë dokumentet bashkë me aplikacionin si në vijim**:**
   - 1.1 Kopjen e letërnjoftimit për personat fizik;
   - 1.2 Kopjen e certifikatës për regjistrimit të biznesit për personat juridik;
   - 1.3 Kopjen e kartelës bankare valide për llogarinë rrjedhëse;
   - 1.4 Për pagesat direkte për lopë qumështore, dele dhe dhi, si dhe kopjen e regjistrit të gjedhëve të lëshuar nga Njësi për identifikim dhe regjistrim në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës për të gjitha kafshët;
   - 1.5 Për pagesat për sipërfaqe të tokës bujqësore dëshminë nga kadastra mbi sipërfaqen e tokës së punueshme - pa të dhënat e kadastrës për pyje, oborre, që nuk janë tokë bujqësore, në pronësi ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore.
   - 1.6 Dëshmia për pagesën e tatimit në pronë.

Neni 14
Shqyrtimi i aplikacioneve

1. Aplikacioni do të regjistrohet në regjistrin e librit të protokollit në Njësinë komunale përkatëse për bujqësi.

2. Zyrtari përgjegjës në Njësinë komunale përkatëse për bujqësi kontrollon se a është i kompletuar aplikacioni.
3. Aplikuesi pranon një konfirmim për dorëzimin e aplikimit si dhe numrin e protokollit.
4. Nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar, afati shtesë për kompletimin e tij është (5) pesë ditë nga data e aplikimit.
5. Nëse aplikacioni nuk kompletohet edhe pas afatit shtesë prej (5) pesë ditësh të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni atëherë aplikacioni do të refuzohet nga Njësia komunale përkatëse për bujqësi.
6. Njësitë komunale përkatëse për bujqësi do t'i dërgojnë aplikacionet e kompletuara në Njësia e pagesave jo më vonë se pesë (5) ditë pas kalimit të afatit për aplikim.

Neni 15
Verifikimi i kritereve të pranueshmerisë

1. Verifikimi i kritereve të pranueshmërisë përbëhet nga kontrolli administrativ-teknik për të gjithë aplikuesit dhe kontrolli në teren sipas nenit 17 të këtij udhëzimi administrativ.
2. Për pagesa direkte sipas nenit 9 të këtij udhëzimi administrativ kriteret e pranueshmërisë përcaktohen nga të dhënat e sLPIS-it sipas parcelave dhe lokacionit të tyre në ato komuna ku të dhënat janë futur në sistemin e sLPIS-it.

Neni 16
Procedurat e kontrollit

1. Njësia e Pagesave organizon futjen e të dhënave në sLPIS, kryen kontrollin administrativ dhe kontrollin në teren të aplikacioneve para se të merret vendimi për pagesën.
2. Procedimi administrativ kompletohet brenda një periudhe prej 90 ditësh nga data e aplikimit, përveç kulturave lavërtarie- grurë, me vendim për përkrahjen në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative.

Neni 17
Kontrolla në teren

1. Kontrollet në teren bëhen në shkallë prej 50% të aplikacioneve bëhet nga Njësia e pagesave për të verifikuar përmbushjen e kushteve të pranueshmërisë, në veçanti të numrit të kafshëve të deklaruara dhe madhësisë së sipërfaqes së deklaruar.
2. Në komuna ku të gjitha të dhënat e parcelave të aplikuesve janë futur në sistemin e sLPIS, kontrolli në teren mund të zvogëlohet deri në 20%.
3. Në rast të vërejtjes së parregullsive nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministria mund të vendosë të rritë shkallën e kontrolleve në teren.

Neni 18
Procedurat e ankesës

1. Në rast të kontestimit të kontrollit administrativ apo kontrollit në teren, Njësia e Pagesave bënë shqyrtimin e ankesave, duke marr vendim për aprovim apo refuzim të ankesës.
2. Në rast të kontestimit të vendimit për refuzim nga fermeri, Ministria cakton një komision profesional për shqyrtim të ankesave.
3. Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni mund të vërtetoi, anuloi Vendimin e Njësisë së Pagesave apo mund të rekomandoi për superkontroll apo ri verifikim.
4. Ministria me vendim të veçantë e cakton komisionin për superkontroll – ri verifikim.

Neni 19
Sanksionet administrative

1. Në rast të konstatimit të parregullsive në dallimin midis numrit të deklaruar dhe të përcaktuar të kafshëve dhe dallimin midis sipërfaqes së deklaruar dhe sipërfaqes të mbjellura me grurë të përcaktuar, duhet ti zbatoi sanksionet. Pagesa do të kryhet në bazë të gjendjes faktike
2. Nëse dallimi midis numrit të deklaruar dhe të përcaktuar të kafshëve ose sipërfaqes së tokës bujqësore është prej 0-10% nuk do të aplikohet sanksioni.
3. Nëse dallimi midis numrit të deklaruar dhe të përcaktuar të kafshëve ose sipërfaqes së tokës bujqësore është mbi 10% dhe nën 50% atëherë sanksionimi i aplikuesve do të zbatohet prej 0-50%, pagesa për kafshë të përcaktuara ose sipërfaqe të përcaktuar do të zvogëlohet në mënyrë proporcionale.
4. Shuma e fondeve në të cilat fermeri do të kishte të drejtë përfitimi për numrin e kafshëve të përcaktuara ose sipërfaqen e tokës bujqësore të përcaktuar zvogëlohet sipas përqindjes së dallimit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Nëse dallimi midis numrit të deklaruar dhe të përcaktuar të kafshëve ose sipërfaqes së tokës bujqësore është mbi 50%, atëherë fermeri nuk ka të drejtë për asnjë lloj përkrahje të drejtpërdrejt dhe aplikacioni i tij refuzohet dhe sanksionohet sipas paragrafit 6 të këtij neni.
6. Aplikuesit, duhet të përjashtohen nga programet përkrahëse deri në (3) tri vite në bazë të vendimit të Njësisë së pagesave nëse bëhet fjalë për së paku njërën nga shkeljet e mëposhtme:
   1.1 kur aplikuesi ka paraqitur autoriteteve të dhëna të rrejshme;
   1.2 kur aplikuesi ka penguar kontrollin zyrtar të punës.

Neni 20
Moszbatimi

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 38 Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Neni 21
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.04/2010 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2010, dt, 27.05.2010 dhe Udhëzimi Administrativ Nr.11/2011 për ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2010 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2010, dt.25.03.2011.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 18.04.2011

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Blerand Stavileci

_____